

Dog Coaching Center

Tiranë, Shqipëri

www.dogcoachingcenter.com

Trajnerët:

Kornelia KOKONA

Arbër TËRVOLI



Mësimi i litarit

Një guidë për pronarët



Në mënyrë që ne të shijojmë një shëtitje, qeni fillimisht duhet të krijojë një lidhje pozitive me litarin duke e njohur atë si një mjet drejtues me të cilin ju i ofroni siguri dhe mbrojtje. Në rast se gjatë shëtitjes litari qëndron vazhdimisht i tensionuar (qeni tërheq), kjo e bën atë të mendojë që litari është një burim stresi dhe njëkohësisht ju nuk jeni të vlefshëm për sa kohë nuk ofroni drejtim e qetësi për qenin. E njëjta gjë kur litari përdoret si mjet ndëshkimi apo korrigjimi.

HAPI I PARË - Teknika e litarit të gjatë

Vendosi qenit një litar trajnimi të gjatë rreth 3-5 metra. Nëse nuk keni një litar të tillë, mund të shtoni një litar tjetër në fund të litarit standart të trajnimit. Është e rëndësishme që litari të jetë vendosur sa më lartë qafës, mbrapa veshit (për këtë do të flasim më qartë në hapin e dytë).

Filloni të punoni në një zonë të gjerë me shumë pak shpërqendrim në mënyrë që të vlerësoni reagimin e qenit në këtë ambient. Do tju ndihmonte tja nisnit këtë ushtrim në një zonë me beton ose asfalt, pasi ambientet me bar apo dhë kanë më shumë aroma dhe qentë nuhasin shpesh.

Kur të nisni ushtrimin palosni litarin në njerën dorë dhe me dorën tjetër sigurohuni që litari nga qafa e qenit të mos preki tokën apo të futet midis këmbëve të qenit duke mos qenë në asnjë moment i tendosur.



Fillimisht mos perdori asnjë fjalë, tingull apo zëra. Këto mund të krijojnë ekzaltime teksa ju po mundoheni t'i mësoni qenit tuaj qetësinë.

Ecni duke u kthyer 180 gradë (mbrapsht) sa herë që qeni fillon shkëputet përpara jush. Mos prisni që qeni të shkojë në fund të litarit. Ktheni shpinën duke liruar lehtë gjatesinë e litarit për të lënë tendosjen të ndodhi natyralisht kur qeni të arrijë fundin e litarit.

Vazhdoni të ecni natyralisht në këtë drejtim duke palosur litarin teksa qeni afrohet vet tek ju. Në asnjë moment mos ndaloni ecjen për të pritur që qeni të marri një vendim, por qëndroni vazhdimisht në lëvizje në krahun e kundërt të ecjes së qenit sa herë që ai fillon të distancohet nga ju. Qeni duhet tju ndjekë ju, por jo e anasjellta.

Pas 1-2 minutash që jeni duke praktikuar këtë, filloni të shtoni fjalën HAJDE në momentin e krjimit të presionit kur qeni është në fund të litarit. Kjo do ta ndihmojë qenin të ridrejtohet tek ju.

Filloni shpërbleni momentin që qeni juaj ecën drejt jush me një BRAVO, apo duke përplasur dorën tek kofsha juaj për ta ftuar që tju ndjekë ndërkohë që jeni në lëvizje. Një qen do e ketë më të lehtë të ndjekë një njeri që shpërblen afrimin tek ai, sesa dikë që qëndron neutral. Kjo vlen edhe më shumë për këlyshët apo qen të cilët janë të frikësuar nga stimujt e jashtëm. Minimizoni fjalët inkurajuese nëse qeni ekzaltohet më shumë seç duhet.

Ecni duke mbajtur shpinën drejt, duart lirshëm për të transmetuar vetëbesim tek qeni juaj. Gjuha jonë e trupit është ajo që transmeton energjinë tonë.

Rrisni ngadalë shpërqendrimet brenda seancës duke ecur drejt tyre qëllimisht. Për shembull një



zog, një makinë që ecën pranë jush apo edhe një qen tjetër nëse mendoni që qeni juaj është gati. Kthehuni përsëri në një ambjent me më pak shpërqendrim duke punuar kësaj here me litar më të shkurtër. Sigurohuni të mbyllni një seancë të tillë brenda një periudhë 15-30 minuteshe. Për këlyshët rekomandohet minimumi i kësaj kohe.

HAPI I DYTE - Përgatitja për shëtitje

Pasi keni punuar disa herë me Hapin e parë (e njohur ndryshe si "Teknika e litarit të gjatë") qeni ka mësuar që presioni i krijuar në litar ofron drejtim dhe qetësi për të. Tani është koha që të nisni një shëtitje normale në qytet për tu përballur me sfidat e përditshme si këmbësorë, biçikleta, makina dhe qen të tjerë.

Shëtitja nuk nis me daljen tuaj në rrugë, por që në shtëpi. Madje shëtitja nis nga momenti që ju prekni litarin e qenit tuaj. Nëse ne i vendosim litarin një qeni të ekzaltuar i cili po leh apo vrapon nëpër shtëpi, ne do të jemi duke e inkurajuar atë që kjo lloj energjie hiperaktive të shfaqet gjatë gjithë shëtitjes.

Ajo që do ta ndihmonte qenin të kuptojë se qetësia është ajo çfarë shpërblehet në marrëdhënien tuaj, është që sa herë ai shfaq një shenjë ekzaltimi, ju vendosni përsëri litarin në vendin e tij dhe qëndroni pa lëvizur deri kur qeni qetësohet. Në varësi të ekzaltimit të qenit mund tju duhet disa minuta deri kur ai të qetësohet. Me praktikë të përditshme, kjo kohëzgjatje do të zvogëlohet.

Ka katër pozicione se si mund të vendoset litari i trajnimit tek qeni juaj:

“Pozicioni i Tërheqjes” do të inkurajojë qenin tënd të tërheqi në litar. Litari pozicionohet shumë poshtë qafës dhe kjo është një zonë tek e cila qeni merr shumë fuqi. Ky pozicion është i ngjashëm me truporet e qenve.



“Pozicioni Mbytës” është kur litari mbështetet në trake dhe gjatë tërheqjes së litarit do të shkaktojë kollitje. Do të duket sikur qeni po mundohet të pastrojë fytyrën. Sigurisht kjo nuk është një mënyrë e shëndetshme për të shëtitur qenin. Ky pozicion është i ngjashëm me qaforet normale.



“Pozicioni i Punës”, i cili është lart qafës dhe direkt mbrapa veshëve. Ky është pozicioni në të cilin qeni është më i ndjeshëm në litar. Këtu do të kërkohej më pak tension litar për të manovruar qenin në drejtimin që ti do. Kjo vendosje mund të kërkojë disa ripozicionime të litarit herë pas here, sepse si pasojë e gravitetit litari mund të rrëshkasë poshtë qafës.



"**Litari në formë 8**" është një metodë që ne e përdorim shumë tek qenushët të cilët gjejnë vështirësi për tu fokusuar tek pronari prej frikës apo edhe ekzaltimit. Kjo metodë bëhet duke hapur një lak të madh dhe duke krijuar një formë 8 poshtë qafës së qenit. Pjesën e poshtme të formës 8 e vendosim sipër nofullës së qenit. Këtë metodë rekomandojmë të mësohet vetëm në praninë e një profesionisti.



Në momentin që litari është vendosur në pozicionin e duhur dhe qeni është i qetë, afrohuni tek dera për të dalë nga shtëpia. Sigurohuni që qeni të qëndrojë i ulur gjatë gjithë kohës që ju hapni derën dhe prisni që t'ju bëjë kontakt me sy për ta ftuar që të dilni së bashku.

HAPI I TRETË - Përballja me botën

Në momentin që ju nisni shëtitjen në rrugët e qytetit, mund të shkëmbeheni vazhdimisht me turma njerëzish, bicikleta, qen apo mace. Nëse keni një qen i cili është reaktiv, apo edhe shumë i ekzaltuar sa herë që shkëmbeheni me një shpërqëndrim, nuk do të ishte ide e mirë të lejoni që qeni të afrohet fizikisht drejt tyre. Ky lejim vetëm do të inkurajonte sjellje të cilat ju doni që ai të eliminojë.

Mos takoni qenin tuaj me qen të tjerë apo njerëz në rast se ai është duke tërhequr drejt tyre, pasi kjo tregon që është ai i cili po merr vendimet në atë moment. Një mënyrë shumë efektive për të vendosur një kufi për qenin tuaj është duke e kaluar në krahun e kundërt nga qeni / njeriu / bicikleta që po shkëmbeheni. Nëse ju jeni midis qenit tuaj dhe shpërqëndrimit, ju nuk jeni vetëm një barrierë fizike, por edhe psikologjike midis atij dhe ekzaltimit. Vazhdimi i ecjes e bën qenin që të kanalizojë energjitë e tij në lëvizje duke minimizuar reagimin emocional.

Nëse e shikoni të vështirë menaxhimin e qenit edhe duke e mbajtur nga krahu i kundërt, kthehuni tek HAPI I PARË duke aplikuar teknikën e litarit të gjatë për të fituar fokusin e qenit tuaj.

Sa herë që ndaloni në shëtitje, për të pritur semaforin, për të takuar një mik, apo çfarëdo arsye, uleni qenin duke përdorur presionin e litarit pingul me qafën e tij. Mbani presionin deri kur ai të ulet dhe liroheni atë menjëherë pasi është ulur. Nëse përdorni fjalë psh. ULU, përdore vetëm 1 herë. Përdorimi i vazhdueshëm i fjalëve, sjell vetëm ankth tek ju edhe tek qeni. Nëse ne i kërkojmë qenit të ulet kur po ndalojmë, jemi njëkohësisht duke i kërkuar të relaksohet. Në rast se ai çohet, me qetësi duke përdorur vetëm litarin uleni në të njëjtin pozicion.

*Përdorni një kombinim të të gjitha teknikave për të zbuluar se çfarë funksionon më mirë për ju dhe qenin tuaj. Asnjë qen nuk është i njëjtë si në reagimet e tij, por edhe në aftësinë për të thithur informacionet që ne po i komunikojmë. Jepini kohën e duhur atij që të përparojë.



Dog Coaching Center

Tiranë, Shqipëri

www.dogcoachingcenter.com

Trajnerët:

Kornelia KOKONA

Arbër TËRVOLI

